



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.869/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit Auto Sallon Xeni shpk me seli në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson K.B. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit - paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.244/23 datës 01.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit Auto Sallon Xeni shpk me seli në Ferizaj , e ushtruar me datë 16.06.2023

Ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.244/2023 i datës 01.06.2023

Aprovohet propozimi i paditësit – propozuesit Auto Sallon Xeni shpk me seli në Ferizaj, dhe Shtyhet ekzekutimi i aktit administrativ përfundimtar- vendimit nr.01.3.2.2/4634 i datës 30.03.2023 i të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, deri në vendosjen e çështjes me vendim të plotfuqishëm.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është Refuzuar si i pabazuar propozimi i paditësit-propozuesit Auto Sallon Xeni shpk me seli në Ferizaj, me të cilin ka kërkuar nga gjykata, që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurës, Dogana e Kosovës në Prishtinë, nr.01.3.2.2/4634 datës 30.03.2023.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi - propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, K.B. avokat në Prishtinë me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore të LPK-së, dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e propozuesit, Ndryshohet Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, K.F.nr.244/2023 i datës 01.06.2023, ashtu që Aprovohet kërkesa e paditësit si e bazuar dhe Shtyhet ekzekutimi i

aktvendimit nr.01.3.2.2/4634 i datës 30.03.2023 të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilin është vërtetuar aktvendimi nr.04.1.5/4335 dt.28.02.2023 i lëshuar nga Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve të paditurës, deri në vendimin definitiv, ose aktvendimi të Prishtet dhe Lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, Dhomat e shkallës së dytë, gjen se paditësi Auto Sallon Xeni shpk me seli në Ferizaj, ka ushtruar padi në Dhomat e shkallës së parë me datë 23.05.2023, kundër vendimit të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë nr.01.3.2.2/4634 dt.30.03.2023. Me të njëjtën datë paditësi-propozuesi ka paraqit në gjykatë kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paditurës deri në vendimin definitiv nga gjykata lidhur me këtë çështje të konfliktit administrativ.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka Refuzuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se i njëjti, nuk e ka bërë të arsyeshme kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit ashtu siç e parasheh neni 22 par.6 i LKA-së.

Dhomat e shkallës së dytë, pikëpamjet juridike të Dhomave të shkallës së parë, nuk mund të përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*. Në rastin konkret paditësi-propozuesi, me propozim ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurës Dogana e Kosovës nr.01.3.2.2/4634 dt.30.03.2023, deri në vendimin definitiv nga gjykata lidhur me këtë çështje të konfliktit administrativ. Ndërsa Dhomat e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, në arsyetimin e të njëjtit në kundërshtim me dispozitën ligjore të cekur më lartë, ka vendosur për refuzimin shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, vendim i cili nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm, mirëpo përmban vetëm një përshkrim të nenit 22 të LKA-së, i cili nen flet për kushtet ligjore të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, për të cilën arsye aktvendimi i ankimuar për shkak të parregullsive që ka nuk mund të ekzaminohet, meqë dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetim e tij, arsyet dhe faktet vendimtare nuk janë vlerësuar fare dhe ato arsyeime që janë bërë në përshkrimin e arsyetimit janë të paqarta dhe kundërthënëse.

Gjithashtu, Kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se Dhomat e shkallës së parë nuk ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejt, siç e parasheh dispozita e nenit 183 e LPK-së, e aplikueshme sipas nenit 63 të LKA-së.

Kolegji i kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të Dhomave të shkallës së parë, lidhur me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë edhe me të meta juridike për shkak të qëndrimit të gabuar juridik të Dhomave të shkallës së parë, të parapara me nenin 183, respektivisht 183.1 ku përcaktohet se: *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*. Në rastin konkret Dhomat e shkallës së parë nuk e ka vlerësuar fare ose e ka vlerësuar në mënyrë të gabuar faktin se me mos shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, paditësit-propozuesit mund ti shkaktohet dëm i pariparueshëm.

Dhomat e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejt faktet të cilat ndikojnë direkt në shkaktimin e dëmit të pariparueshëm të paditësit-propozuesit, e cila në vendimin e saj nuk e ka pasur parasysh bilancin bankar bashkangjitur në shkresat e lëndës, në raport me pezullimin e autorizimit për depo doganore, ku paditësit – propozuesit i është pamundësuar të përdor këtë autorizim për depo doganore, dhe ky veprim i menjëhershëm, i drejtpërdrejt, real ndaj paditësit –propozuesit, ndikon drejtpërdrejt në rrezikimin e ushtrimit të mëtejme të veprimtarisë së paditësit-propozuesit.

Dhomat e shkallës së parë, ka pasur për obligim që të shqyrtoj edhe kërkesat ligjore, nga neni 22 paragrafi 2 të LKA-së, që parasheh: *se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar*. Në rastin konkret sikurse shihet nga shkresat e lëndës, propozuesi posedon autorizimin për depo doganore WH326, me taksa të pezulluara në vlerë prej 50,000.00€, për çka ka paguar garancionin doganor, të vlefshëm deri me datën 31.01.2024 në Kompaninë e Sigurimeve Sigkos në Prishtinë (numri i policës ...), andaj Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se Dhomat e shkallës së parë, nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, ku si rezultat i kësaj është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale. Në këtë rast Kolegji vlerësoi se propozuesi ka siguruar autorizimin për depo doganore, që nënkupton se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe në anën tjetër e paditura Dogana e Kosovës – Sektori i Akcizës, Tarifës Origjinës dhe Procedurave, në vendimin e saj 4335/28.02.023 datës 02.03.2023, nuk e përcakton se cilat dispozita ligjore të legjislacionit doganor lejojnë pezullimin e importit nën regjimin IM7 për autorizimin WH326 ndaj paditësit, nuk është përcaktuar se pezullimi është kriter në autorizimin WH326 për drejtimin e depos doganore të lëshuar nga e paditura Dogana e Kosovës, por pezullimi i autorizimit vetëm në bazë të një përkrahimi se paditësi ka shkaktuar kundërvajtje doganore nga neni 276 pika (h) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi se me aprovimin e propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues të ushtruar nga ana e propozuesit, nuk do ta dëmtonte tani të paditurën, por për kundër kësaj do të eliminonte rrezikun që paditësi - propozuesi mos të rrezikohet në ushtrimin e mëtejme të veprimtarisë ekonomike.

E paditura duhet të presë nga ana gjykatës vendimin meritore në këtë çështje, në mënyrë që nga e njëjta të vërtetohet se vendimi i nxjerrë nga e paditura është i ligjshëm dhe i drejtë. Gjithashtu, vendimi i Dhomës së Shkallës së Dytë për aprovimin e propozimit për shtyrje të ekzekutimit të

vendimit nuk e prejudikon çështjen kryesore, por ka të bëjë vetëm sa i përket ndalimit të shkaktimit të dëmit tani për tani për paditësin, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Andaj kolegji i kësaj gjykate, duke i marrë parasysh pretendimet e paraqitura me propozim si dhe të tjerat të cilat gjenden në padi dhe në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKAsë, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky vendim nuk e prejudikon vendosjen në mënyrë meritore të padisë.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.869/23 datë 10.07.2023

Kryetari i Kolegjit  
Krenar Berisha